


Nr. 9573 Rep.

Nr. 1088 Kol.



## KONTRATE SHITJE

Sot me date 10.10.2003(dhjete tetor dymije e tre)ne Elbasan ne zyren time te ndodhur prane Gjykates se Rrethit Elbasan, para meje noteres Majlinda Lato u paraqiten personalisht palet kontraktuese,shtetas shqiptare:-----

*Ne cilesine e shitesit:* z.**Fatmir Karaj** i biri Agimit, lindur me 13.11.1963 ne Elbasan dhe banues ne Elbasan dhe *Ne cilesine e bleresit:*z.**Arjan Shyti** i biri Hydri,lindur me 11.05.1960 ne Kavaje dhe banues ne Elbasan.

Qe te dy madhore dhe te afte per te kryer veprime juridike ,shtetas shqiptare,te njohur nga une noteria ne baze te dokumentave identifikues qe me paraqiten te cilet me kerkuan redaktimin e ketij akti si vijon:-----

Shitesi Fatmir Karaj dhe bleresi Arjan Shyti jane ortake te shoqerise "IMPULS-95" sh.p.k me seli ne Elbasan,tek Pika e Karburantit Autostrade-Bradashesh, duke zoteruar secili nga 50% te kuotave, kapitalit te shoqerise, e cila eshte e rregjistruar ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane me nr.12445 vendimi date 11.10.1995.--

Shitesi Fatmir Karaj deklaroi se 50% te kuotave,kapitalit te saj, qe zoteron ne shoqerine "IMPULS-95" sh.p.k ia shet bleresit Arjan Shyti, ortak i kesaj shoqerie, perkundrejt vlefes prej 50.000 leke (pesedhjetemije leke) te cilat shitesi deklaroi se i ka marre te gjitha ne dore nga bleresi jashte kesaj zyre noterie te numeruara.-----

Dhe bleresi Arjan Shyti deklaroi se eshte dakort qe te bleje 50% te kuotave , kapitalit, te shoqerise "IMPULS-95" sh.p.k te pershkruar me siper perkundrejt vlefes prej 50.000 leke dhe deklaroi se eshte likujduar me shitesin per te gjitha shumen e shprehur ne kete kontrate jashte kesaj zyre noterie.-----

Qe ne kete moment pronesia mbi 50% te kuotave qe shitesi Fatmir Karaj zoteron ne shoqerine "IMPULS-95" sh.p.k, kalon nga shitesi Fatmir Karaj tek bleresi Arjan Shyti e lire nga cdo pengese ligjore,duke u bere shoqeria "IMPULS-95" sh.p.k. me nje ortak dhe administrator te vetem duke zoteruar ortaku Arjan Shyti 100 % te kuotave, kapitalit, te shoqerise "IMPULS-95" sh.p.k.-----

Kjo kontrate shitje hartohet duke u bazuar ne nenin 705 e vijues te Kodit Civil.----

Mbi sa me siper u redaktua ky akt ne kater kopje te njejta origjinale,iu lexua paleve ne kontrate me ze te larte,te cilet pasi me deklaruan se e kane degjuar dhe e kane kuptuar dhe eshte konform vullnetit te tyre te shprehur,me doren e tyre dhe me vullnet te lire e nenshkruan ne pranine time noteres rregullisht.Ne fund u vertetua dhe nga une noteria sipas ligjit dhe konform tij.

PALET KONTRAKTUESE

SHITESI

Fatmir Karaj

*Fatmir Karaj*  
*[Signature]*

NOTERE  
MAJLINDA LATO

*[Signature]*

BLERESI

Arjan Shyti

*ARJAN SHYTI*  
*[Signature]*